



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 622/2 Prot

Tiranë, më 11.11.2022

V E N D I M

Nr. 136, datë 11.11.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë në lidhje me procedimin disiplinor; të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës; respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil; si dhe vlerësimin e rezultateve në punë ndaj inspektorit *** , pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një informacioni me objekt: “Ankesa lidhur me shkeljet flagrante të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndaj inspektorit *****”, janë ngritur pretendime se janë lejuar paligjshmëri lidhur me procedurën disiplinore të zhvilluar nga organi disiplinor, vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe me mosrespektimin e disa prej të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil, ndër të cilat: “E drejta e kushteve të përshtatshme të punës dhe e drejta e mbrojtjes nga shteti” dhe “Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm”, parashikuar respektivisht nga nenet 33 dhe 43, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Duke marrë shkas nga sa më sipër, bazuar në nenin 16, të Kreut III, “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u administrua dokumentacioni shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit të proceduar, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. 3440/1 prot, datë 22.09.2022, nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, me lëndë: “*Kthim përgjigje shkresës nr. 620/1, datë 13.09.2022*”, i pasqyruar në procesverbalin e konstatimit datë 22.09.2022, si dhe dokumentacioni i përcjellë nga ky institucion me shkresën nr. 3801/1 prot, datë 06.10.2022, me lëndë: “*Kthim përgjigje*”.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të mësipërme, rezulton e vërtetuar se me shkresën nr. 3109 prot, datë 24.08.2022, me lëndë: “*Relacion mbi veprimtarinë e inspektorit ******”, Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në cilësinë e eprorit direkt, ka konstatuar veprime dhe mosveprime që vijnë në kundërshtim me pikën 3/a, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke i klasifikuar si shkelje të rënda, si dhe duke propozuar nisjen e ecurisë disiplinore për nëpunësin civil *****.

Në këtë përfundim është arritur nga evidentimi i praktikës së inspektimit të subjektit “*Atom*”, me NIPT L22203042N, me nr. 3027 prot, datë 15.08.2022, realizuar më datë 16.08.2022 dhe praktikës së inspektimit të subjektit “*Kapidani*” me NIPT J83211203F, me nr. 3026 prot, datë 15.08.2022, të realizuar më datë 17.08.2022.

Me shkresën nr. 3109/1 prot, datë 24.08.2022, të titullarit të institucionit, me lëndë: “*Njoftim për fillim ecurie disiplinore*”, nëpunësi civil ***** , ka marrë dijeni në datën 25.08.2022, duke u njoftuar për shkeljen e rëndë të pretenduar se është kryer prej tij, si dhe për të drejtat e parashikuara nga pika 13, e Kreut II, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, ku përfshihen:

- paraqitja me shkrim dhe sqarimet rreth kësaj shkeljeje dhe respektimin e afatit kohor që është data 01.09.2022, brenda së cilës duhet të paraqiten këto sqarime dhe argumentat mbështetëse;
- zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e shkeljes disiplinore në datën 02.09.2022, në ambientet e ISHMT-së, salla e mbledhjeve, ora 10:00;
- njohja e dosjes së procedimit;
- e drejta për t’u dëgjuar vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova apo për të kërkuar marrjen e tyre, me paralajmërimin e

vazhdimet të ecurisë disiplinore në mungesë, në rast mosparaqitjeje personalisht apo përmes përfaqësuesit ligjor pas njoftimeve.

Bazuar në pikën 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikës 1 dhe 2, të Kreut I, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, si dhe bazuar në relacionin nr. 3109 prot, datë 24.08.2022, nëpërmjet urdhrin nr. 190, datë 24.08.2022, protokolluar me nr. 3112 prot, datë 24.08.2022 “Për ngritjen e komisionit disiplinor”, është proceduar me ngritjen e Komisionit Disiplinor, i përbërë nga:

- ***** , Drejtor i Drejtorisë Teknike, e cila kryeson komisionin;
- ***** , Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, në rolin e eprorit direkt;
- ***** , Përgjegjëse e Sektorit të Pronësisë Industriale;
- ***** , Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, drejtues i Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Përfaqësuesi i DAP, ***** , i caktuar përmes autorizimit nr. 5078 prot, datë 01.09.2022, të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike.

Përbërja e Komisionit Disiplinor vlerësohet në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të Kreut I, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”. Anëtarët e Komisionit Disiplinor kanë nënshkruar deklaratën “Për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komisionit Disiplinor”, bazuar në nenin 37, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Institucioni ISHMT, me shkresën nr. 3112/1 prot, datë 25.08.2022, me lëndë: “Përcjellje dokumentacioni lidhur me fillimin e procedimit disiplinor dhe caktim përfaqësuesi të Departamentit të Administratës Publike në Komisionin Disiplinor”, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike mbi caktimin e një përfaqësuesi në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor, si dhe mbi rendin e ditës së seancës së organit disiplinor (KD), të caktuar për t’u zhvilluar më datë 02.09.2022, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve pranë ISHMT, referuar pikës B/1, të udhëzimit nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në ushtrim të së drejtës ligjore për të paraqitur sqarimet rreth shkeljes së pretenduar në ngarkim të tij, inspektori ***** , ka paraqitur me shkrim kundërshtimet përkatëse mbi

shkeljen disiplinore të konstatuar në ngarkim të tij, përmes shkresës nr.3109/2 prot, datë 31.08.2022, me lëndë: *“Kundërshtimin e shkeljes disiplinore mbi relacionin nr. 3109 prot, datë 24.08.2022”*, drejtuar Komisionit Disiplinor.

Seanca dëgjimore e caktuar për t'u zhvilluar më datë 02.09.2022, ora 10:00, referuar shkresës nr. 3109/1 prot, datë 24.08.2022, me lëndë: *“Njoftim për fillim ecurie disiplinore”*, është pasqyruar në procesverbalin përkatës nr. 3109/3 prot, datë 02.09.2022, në referim të nenit 16, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*.

Seanca dëgjimore konstatohet të jetë zhvilluar pa pjesëmarrjen e anëtares *****/Përgjegjës i Sektorit të Pronësisë Industriale, por seanca e zhvilluar konsiderohet e rregullt nga pikëpamja ligjore, duke iu referuar faktit se në zbatim të pikës 5, të Kreut 1, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, parashikohet se: *“Komisioni disiplinor mbledhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale”*, e për rrjedhojë referuar pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, parashikohet se: *“Mbledhja e organit kolegjial, është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij”*.

Në procesverbalin nr. 3109/4 prot, datë 12.09.2022, është pasqyruar rezultati i votimit nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, me pesë vota pro, mbi caktimin e masës disiplinore të propozuar ndaj nëpunësit civil ***** *“Mbajtjen e 1/8 (një e teta) të pagës së plotë për një periudhë 3 (tre) muaj”*.

Komisioni Disiplinor ka përfunduar procedurën disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil ***** *“Inspektor”*, në Sektorin e të Drejtës së Autorit, në Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me marrjen e vendimit përfundimtar nr. 6, datë 16.09.2022, me nr. 3537 prot, datë 16.09.2022, duke vendosur dhënien e masës disiplinore *“Mbajtjen e 1/8 (një e teta) të pagës së plotë për një periudhë 3 (tre) muaj”*.

Komisioneri konstaton se vendimi përfundimtar nga pikëpamja formale, është shpallur tej afatit ligjor të parashikuar nga udhëzimi nr. 01, datë 02.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, në të cilin parashikohet se: *“Vendimi shpallet menjëherë dhe në pamundësi jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes”*.

Shqyrtimi i çështjes në ngarkim të nëpunësit civil ***** ka përfunduar në seancën e datës 02.09.2022 dhe vendimi përfundimtar është shpallur më datë 12.09.2022. Ky veprim në thelb nuk cënon procedimin disiplinor dhe as të drejtat procedurale të subjektit të procedimit, në kuptim të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, por nga ana e organit disiplinor duhet të tregohet kujdes në vijim, të mos përsëritet kjo lloj parregullsie, në raste të tjera eventuale.

Vendimi përfundimtar, është arsytuar brenda afateve të parashikuara nga udhëzimi nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”* dhe përmban gjithë elementët e detyrueshëm të formës të parashikuar nga ky udhëzim, në pikën 19, të Kreut II, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, si dhe në nenin 99 e 100, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*.

Akti i është njoftuar nëpunësit civil *****, rregullisht me shkresën nr. 3537/1 prot, datë 16.09.2022, njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe Departamentit të Administratës Publike.

Sa më sipër, rezulton se procedimi disiplinor i filluar ndaj nëpunësit civil është zhvilluar konform legjislacionit në fuqi në thelbin e tij, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, duke garantuar të drejtat procedurale të subjektit.

Pretendimi i ngritur nga pala se asnjë nga anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk është ekspert i të drejtës së autorit e për rrjedhojë është e pamundur të kryhet një vlerësim i drejtë dhe i paanshëm prej tyre, Komisioneri vlerëson se nuk është i bazuar në kuadrin ligjor. Referuar Kreut I, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, përcaktohen në mënyrë shteruese cilësitë e anëtarëve të Komisionit Disiplinor për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, si dhe për komunat.

Lidhur me pretendimin tjetër të nëpunësit të proceduar, mbi mbrojtjen e sekreteve tregtare të evidentuara në procesverbalet e inspektimit, Komisioneri çmon me rëndësi të theksojë se në zbatim të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe parimit të mbrojtjes së të dhënave, të parashikuar nga neni 9, i ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, organi publik ka të drejtë që të njihet gjatë procedurës administrative me të dhëna personale apo me të dhëna që lidhen me

veprimtarinë tregtare ose profesionale, të cilat mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke patur njëkohësisht detyrimin të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

Lidhur me pretendimin e ngritur prej nëpunësit në fjalë, se nga ana e drejtuesve i është kërkuar të veprojë për të zbatuar urdhra abuzivë, pa shkrim apo verbalë, Komisioneri vëren se në zbatim të pikës 2 dhe 3, të nenit 43, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Nëpunësi civil ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit”*, si dhe *“Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrat të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim”*, çka në rastin konkret nuk rezulton të jetë vepruar sipas këtij rregullimi ligjor.

Sa i përket akteve verbale, referuar nenit 98, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohen qartë format e akteve administrative, si dhe vlen të theksohet se në përmbajtjen e nenit 22 dhe 23, të ligjit nr.90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e mbikëqyrjes së institucionit të varësisë, personi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe masat që mund të ndërmerren në rastet kur ngrihen pretendime mbi ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve administrative.

Në lidhje me pretendimin tjetër mbi mosplotësimin e kushteve të punës, referuar informacionit të përcjellë me shkresën nr. 3440/1 prot, datë 22.09.2022, nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, me lëndë: *“Kthim përgjigje shkresës nr. 620/1, datë 13.09.2022”*, parashtrohet se nga ana e nëpunësit civil ***** , nuk është ngritur asnjë pretendim, si gjatë kohës që ka ushtruar funksionet në ISHMT ashtu dhe gjatë procedimit disiplinor për kushte të papërshtatshme pune, apo të jetë urdhëruar në formë dhe mënyrë të paligjshme për kryerjen e detyrave.

Sa më sipër, lidhur me pretendimet mbi kushtet e punës apo detyrimin për të zbatuar urdhra abuzivë, pa shkrim apo verbalë, në zbatim të pikës 1, të nenit 82, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palën, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij. Në këtë kuptim, nëpunësi civil nuk ka paraqitur asnjë akt, dokument apo kërkesë, përmes së cilave mund të provojë faktet mbi të cilat mbështet pretendimet e tij.

Lidhur me pretendimet e nëpunësit civil mbi parregullsi në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, Komisioneri konstaton se për nëpunësin civil *****, është kryer procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-30.06.2022, nga Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, i cili në cilësinë e eprorit direkt, ka vepruar në rolin e zyrtarit raportues, për shkak të liritimit nga detyra të Përgjegjësit të Sektorit të së Drejtës së Autorit, në Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale.

Përgjegjësi i Sektorit të së Drejtës së Autorit, me aktin e dorëheqjes nr. 745, datë 01.04.2022, është liruar nga detyra me urdhrin nr. 99, me nr. 1085 prot, datë 20.04.2022 “Për lirim nga detyra”, i cili i ka sjellë efektet më datë 29.04.2022. Përgjegjësi i Sektorit të së Drejtës së Autorit, në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë nuk ka realizuar procesin e vlerësimit të pjesshëm të rezultateve në punë për nëpunësit në vartësi, për periudhën gjatë së cilës ka ushtruar detyrën, në zbatim të detyrimit të parashikuar nga pika 6, e Kreut III, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, që ka vepruar në cilësinë e zyrtarit raportues, në kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil *****, nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka bërë komentet përkatëse në pikat e **Ndarjes C** dhe të **Ndarjes Ç**, të formularit të vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive.

Për më tepër, nga shqyrtimi në tërësi i formularit të vlerësimit të punës për nëpunësin civil, konstatohet se në aktin e vlerësimit që është duke u shqyrtuar, është plotësuar edhe rubrika e aftësisë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues - aftësia për të përdorur me efektshmëri burimet financiare dhe njerëzore, rubrikë e cila plotësohet vetëm për nëpunësit civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues dhe jo për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të cilës i përket nëpunësi civil në rastin konkret.

Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil ***** ka përfunduar me vlerësimin e përgjithshëm në nivelin “**Kënaqshëm (3)**”, megjithëse në arsyetimin e bërë prej tij, zyrtari raportues është shprehur se: “*Nëpunësi ka realizuar objektivat e punës së tij në kohën e duhur, me seriozitet, përgjegjshmëri dhe korrektësi dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë*”.

Niveli i vlerësimit “**Kënaqshëm (3)**” nuk është si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e arsyetimit të përdorur nga zyrtari raportues dhe ka mospërputhje haptazi midis nivelit të vlerësimit dhe arsyetimit të përdorur, i cili i përfaqësohet nivelit të vlerësimit “**Mirë (2)**”.

Për sa u parashtrua më sipër, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së pretendimeve mbi procedimin disiplinor, të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës, si dhe mbi detyrimin e përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm, nuk janë konstatuar veprime apo mosveprime që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil.

Lidhur me pretendimet e parashtruara për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, duke patur parasysh qëllimin e tij, parashikuar nga pika 1, e Kreut II, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, çmohet se ky proces duhet të konsiderohet se përmban element kundërligjshmërie dhe për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë procesi i vlerësimit si më sipër, duhet përsëritet në përputhje me kërkesat ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, marrjen e masave të menjëhershme për përsëritjen e procesit të vlerësimit nga ana e zyrtarit raportues, Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, së bashku me zyrtarët kundërfirmues dhe autorizues, për nëpunësin *****, për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-30.06.2022, duke respektuar me korrektesë dhe koherencë, kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe duke evituar parregullsitë e përshkruara në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, sipas pikës 1 të këtij vendimi, lihet afat 20 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil duhet të njoftohet me shkrim, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të

përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

5. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe nëpunësi *****.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha